



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK, nr. 310/2015
Datë 04.11.2015

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS, në mbështetje të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 të Ligjit nr. 03/L-233 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 94 par. 4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodi nr. 04/L-082), nenit 122, par. 2 të Ligjit (Nr. 04/L-149) për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, dhe nenit 8 të Rregullores së KGJK-së (01/39), për Organizimin dhe Funksonimin e Panelit për Lirim me Kusht, në mbledhjen e mbajtur me 04 nëntor 2015, nxjerr këtë:

VENDIM

1. Anëtarët e Panelit për Lirim me Kusht kompensohen me shumën shtatëdhjetë (70) euro për seancë të mbajtur, në bazë të Udhëzimit Administrativ për kompensimin e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe anëtarëve dhe zyrtarëve tjerë në komisione.
2. Shuma e caktuar në pikën 2 të këtij vendimi, për anëtarët të cilët nuk janë të përfshirë në listën e pagave të KGJK-së, nënkupton shumën bruto dhe çfarëdo takse apo tatimi i aplikueshëm në Kosovë, në të ardhurat mbi këtë bazë, është barrë e përfituesve të këtij honorari. Pagesa e tyre do të bëhet nga Buxheti i Këshillit Gjyqësor të Kosovës i dedikuar për këtë qëllim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Enver Peci,
Kryesues,
Këshilli Gjyqësor i Kosovës:

Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të Panelit për Lirim me Kusht,
- Sekretariati i Këshillit Gjyqësor;
- Koordinatorit të Panelit për Lirim me Kusht;
- Arkivit të KGJK-së.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK, nr. 311/2015
Datë, 04 nëntor 2015

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS, (KGJK) në bazë të nenit 29 paragrafi 5 dhe nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 të Konventës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore dhe protokollat e saj përkatës, nenit 4 pika 1.24 të Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës si dhe nenet 525-529 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 04 nëntor 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Udhëzimi Administrativ nr.04/2015 për zbatimin e procedurës për kompensimin e dëmit për personat e dënuar ose të arrestuar pa arsye.
2. Autorizohet Sekretariati i KGJK-së që të publikoj këtë Udhëzim Administrativ në ueb faqe të KGJK-së.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Kopje e vendimit i dërgohet:

- Sekretariatit të KGJK-së
- Arkivit



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK, nr. 312/2015
Datë, 04 nëntor 2015

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS, (KGJK) në bazë të nenit 29 paragrafi 5 dhe nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 të Konventës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore dhe protokollat e saj përkatës, nenit 4 pika 1.24 të Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës si dhe nenet 525-529 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 04 nëntor 2015, merr këtë:

V E N D I M

- I. Caktohet komisioni për kompensimin e dëmit për personat e dënuar ose arrestuar pa arsye në përbërje prej:
 1. Fejzullah Hasani, kryetar,
 2. Gyltene Sylejamni, anëtare,
 3. Mejreme Memaj, anëtare,
 4. Rrustem Thaqi, anëtar rezervë,
 5. Faton Bajrami, anëtar rezervë.
- II. Mandati i komisionit është 3 vjet.
- III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Enver Peci,
Kryesues
Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Sekretariatit të KGJK-së
- Departamentit Ligjor SKGJK
- Komisionit



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK, nr. 313/2015
Datë, 04 nëntor 2015

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS, (KGJK) në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 13 të Ligjit Nr. 05/L -032 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/l-199 për Gjykatat, përmes së cilit plotësohet nenin 33 i Ligjit nr.03/l-199 për Gjykatat, nenit 30 të Rregullores mbi Organizmin dhe Veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 04 nëntor 2015, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Rregullorja (Nr.16/2015) për emërimin e interpretëve dhe përkthyesve gjyqësorë.
2. Autorizohet Sekretariati i KGJK-së që ta publikojë Rregulloren në ueb faqe të KGJK-së.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Enver Peci,
Kryesues
Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Sekretariatit të KGJK-së
- Gjykatave
- Arkivit të KGJK-së